



Permbledhje joteknike e aktiviteteve

“Prodhim i Mobiljeve”

ID. 7.12 I. Veprimtaritë e lyerjes/veshjes të aplikuara në sipërfaqe druri.
ID 11.17 Prodhim i mobiljeve, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.



Subjekti: “Demir Cela”

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2021



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Personi fizik “Demir Cela” ushtron aktivitetine tij “Prodhim i mobiljeve” me vendndodhjen ne Tirane Vaqarr VAQARR Rruga Kryesore,ndertese private 2 kateshe,zona kadastrale 3712,me nr.pasurie 41/46. Shoqeria zhvillon aktivitetin “**Prodhim i mobiljeve**”. Siperfaqja e ndertimit eshte 780 m² dhe kapaciteti ne vit eshte 2300 m³/vit.



✚ PERSHKRIMI I SUBJEKTIT

Drejtuesit e subjektit “Demir Cela” i kane kushtuar vemendje te vecante sistemimit te territorit ne te cilin kryen aktivitetin, duke bere mbjellje te pemeve me gjelberim te perhershem si dhe duke sistemuar dhe dekoruar sheshin perpara punishtes sic tregohet edhe ne fotot e meposhtme.

Gjithashtu, territori perpara godinave eshte shtruar me beton dhe jane sistemuar me kanale te posacme ujerat e shiut duke ndihmuar ne sistemimin e sheshit.

➤ *Respektimi i procesit teknologjik te perpunimit te drurit*

Subjekti "Demir Cela" i ka kushtuar nje vemendje te vecante respektimit te normave dhe proceseve teknologjike te perpunimit te drurit. Drejtuesit e subjektit kane pajisur aktivitetin me pajisje te avancuara te kohes ne menyre qe ne proceset teknologjike te perdoren makineri te nje teknologjie te larte dhe bashkekohore.



➤ *Përshkrimi i procesit teknologjik i perpunimit te drurit*

Gjate ketij procesi lenda e pare kalon ne disa faza perpunimi deri sa te kthehet ne elemente te gatshem dhe mobilieri te ndryshme.

Keto faza jane si me poshte:

- Derrrasat priten sipas permasave te caktuara dhe kalojne ne furrat e stazhionimit;
- Me pas derrrasat kalojne ne makineri te veçanta qe quhen multilame te cilat kthejne derrrasen 5.5 m ne elemente me permasa 5.5 cm x 5.5 cm x 200 cm.
- Elementet e rinj keputen ne te gjitha pjeset ku mund te kene nje ne menyre qe te eliminohen keto mbeturina.
- Procesi i fundit ka te beje me bashkimin e te gjithë ketyre elementeve te vegjel me ane te nje makinerie moderne.
- Kalimi i derrases neper keto faza perpunimi sjell formimin e elementeve te gatshem per eksport te cilet sherbejne ne sektore te ndryshem te prodhimit te mobilieve.
- Nje proces tjetër është dhe lysterja e nje pjese te mobiljeve. Lysterja behet me llak, ku perdorimi i tyre është ne nje sasi shume te vogel.



**FOTO TE PAISJEVE**



2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita gjeografike

Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521 m, kurse dy malet më të larta rrez të cilëve shtrihet janë Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m. Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik në perëndim. Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët. Në periferinë veriore kalon lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është rreth 31 km², ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit është 1288 km² dhe përfshin katër qendra: Tiranën, Vorën, Krrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Qendrën e Tiranës e përshkon përroi i Lanës i cili në grykëderdhje bashkohet me lumin Ishëm.

Kushtet klimatike

Ajri është me lageshti mesatare 60-80%. Përsa i përket cilesise se ajrit ai konsiderohet jo shumë i ndotur pasi zona nuk është zone industriale që të prodhojë gaze ndotëse për ajrin. Ndotja e ajrit vjen vetëm nga pluhurat që krijohen nga levizja e automjeteve apo dhe aktivitete të tjera njerezore. Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Sasia mesatare e reshjeve është 1297mm. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit 57m.

Tirana ka 331 ditë me diell në vit dhe këto kushtëzohen nga pozicioni gjeografik, vranësirat dhe pozicioni i vendit të matjes. Intensiteti i rrezatimit të drejtpërdrejtë të diellit është më i lartë në muajin Maj, ndërsa më i ulët në Dhjetor. Kurse vlera më e lartë në mesditë është gjatë muajit Korrik. Reshjet në Tiranë kryesisht përfaqësohen nga rëniet e shiut, që kapin shifrën 128 –139 ditë reshje në vit. Lagështia mesatare ditore e ajrit është rreth 72%. Tirana ka një thatësi të zgjatur që varion nga 9 deri 11 javë në vite.

Tirana - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Ø
Temp. Maks. (°C)	12	12	15	18	23	28	31	31	27	23	17	14	Ø 20,9
Temp. Mini. (°C)	-8	-8	-4	-1	3	6	11	10	5	1	-3	-7	Ø 0,4
Reshje (mm)	135	152	128	117	122	86	32	32	60	105	211	173	Σ 1.353



Era

Eshte një element shumë i ndryshueshem nga një zonë në një tjetër për shkak të ndikimit të madh që relievi ka mbi të. Megjithatë, duke marrë parasysh kushtet gjeografike të zonës dhe relievit përreth, erërat nuk karakterizohen nga një shpejtesi e madhe . Erërat mbizotëruese janë kryesisht lindore dhe juglindore dhe ndonjëherë ka erëra te nxehta.

Lagështia

Zona ne fjale eshte e karakterizuar nga një nivel relativisht i lartë i lagështisë, me një vlerë vjetore mesatare prej 73%. Vlera më e ulët është vërejtur në korrik me 67% dhe më të lartë në dhjetor me 76%.

Toka/Flora/Fauna

Tokat ne kete zone jane ngjyre hiri, kafe qe shtrihen ne formen e brezave vertikale deri ne lartesite me te medha te zones. Ky ekosistem perfaqesohet nga tokat e mbjella me kultura te ndryshme bujqesore dhe nga druret frutore qe jane mjaft te perhapur ne kete rajon. Toka e zones nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson siperfaqe te shfrytezueshme si kullote.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

- **Ndikimet ne toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk ka aplikohen norma shkarkimi ne toke, sic mund të jenë ndryshime në topografinë lokale, erozionin e tokës apo ndryshime të tjera të dukshme. Nuk do të ketë emetime kimike apo depozitime në tokë në vendin ku do te zhvillohet aktiviteti ose rreth zones perreth pasi mjetet qe do te transportojne lendet do te jene te pastra dhe me kushte te rregullta teknike.

- **Ndikimet mbi popullsine**

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsine perreth, pervecse zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjelle punesimin e disa baroreve perreth duke kontribuar sadopak ne rritjen e mireqenies ne zone.

- **Ndikimet ne cilesine e ajrit**

Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij aktivitet nuk do te jene shqetesuese dhe ne nivele te larta. Kryesisht do te kemi emetime vetem nga mjetet e transportit te cilat jane ne norma te uleta sepse jane ne kushte shume te mira teknike.



- **Ndikimet ne uje**

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk shkaktohet ndotje e ujerave nentokesore apo ne ujrat siperfaqesore. Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi shkarkime me karakter ndotes. Te vetmet shkarkime do te jene ato te ujerave higjenosanitar te tualeteve te cilat do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Duke qene se akiviteti ndodhet ne largesi te konsiderueshme nga zonat e banuara dhe bizneset atehere zhurmat nuk perbejne shqetesim per komunitetin. Gjithashtu zhurmat qe gjenerohen nga mjetet e transportit jane ne nivele te uleta sepse mjeteve u eshte bere koalidimi dhe kontrolli i nevojshem, ato jane ne gjendje shume te mire teknike. Zhurmat qe do te gjenerohen nga procesi i punes, jane brenda normave te lejuara per mjedise pune.

- **Mbetjet t prodhuara**

Mbetjet e vetme qe do te prodhohen jane ato urbane te cilat do te grumbullohen ne kosha te vecante Brenda territorit te subjektit me pas do te depozitohen ne vendin e percaktuar nga NJ.Q.V.

- **Ndikimet ne flore dhe ne faune**

Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi ndikime negative ne flore edhe faune. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk i prek as ne menyre te drejteperdrejte as ne menyre te terthorte.

MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V, madje operatori do te vendos koshat qe keto mbetje ti ndaje nga karakteri i tyre.
- Do te sistemohet dhe do te rehabilitohet siperfaqja pas ndertimit dhe gjate operimit te aktivitetit.
- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet te menyre qe te mos krijohen vibrime.
- Ne pjesen e mbetur te siperfaqes se lire mbas ndertimit operatori duhet te mbjelle sa me shume peme per te krijuar nje pamje vizuale te bukur por edhe per te ulur ndikim ne mjedis edhe pse nga te gjitha gjykamit e bera ato jane ne nivele te ulta dhe totalisht te pranueshme.
- Operatori duhet dhe do te jete i kujdeshem ne mirembajtjen e rruges hyrese te subjektit
- Duhet dhe do te kryeje monitorimin e vazhdueshem lidhur me shkarkime ne uje, ajer, token per te qene gjithmon i informuar.



- Masat per mbrojtjen kunder zjarrit te cilat jane shume te rendesishme duke qene se eshte zone e mbrojtur ato jane parashikuar ne projekt dhe jane si me poshte:
 - Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
 - Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e sharresve te zjarrit,rruget e largimit dhe daljet e emergjnces
 - Largimin e materialeve te ndezshme nga ambientet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
 - Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
 - Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
 - Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuarese si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si dhe unifromat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ Detyrat e punonjesve:

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.